



**KOMUNA E MALISHEVËS**



**BULETINI**

---

Nr. 96-Qershor 2011 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>  
[www.malisheva-komuna.org](http://www.malisheva-komuna.org)



**Shtëpia e Kulturës "Tahir Sinani", në Malishevë**



## Përmbajtja:

|                                                                                                                                                                                                                                 |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Bisedohet për ngritje të kapacitetit të ujësjellësit të Banjës e Malishevës dhe fshatrave që furnizohen nga ky ujësjellës .....                                                                                                 | 3  |
| Bëhet pranim dorëzimi i sallës së sportit për SHMU "Imer Krasniqi" të Carrallukës.....                                                                                                                                          | 4  |
| Këshilli i drejtorëve diskuton përgatitjet për festën e 16 Qershorit.....                                                                                                                                                       | 5  |
| KO për shënimin e 16 Qershorit diskutoj shënimin e kësaj dite .....                                                                                                                                                             | 5  |
| Hapet zyra për regjistrim e bizneseve .....                                                                                                                                                                                     | 6  |
| KKSB e vlerëson të qetë sigurinë në Malishevë .....                                                                                                                                                                             | 6  |
| Pallati i sporteve, pritët të hapet në vjeshtën e këtij viti.....                                                                                                                                                               | 7  |
| Komuna dhe UN-HABITAT-i nënshkruan memorandum mirëkuptimi .....                                                                                                                                                                 | 7  |
| KFOR: Malisheva vend i qetë .....                                                                                                                                                                                               | 8  |
| Bordi i Drejtorëve diskuton përgatitjet përfundimtare për shënimin e 16 Qershorit .....                                                                                                                                         | 9  |
| KK miratoi propozimet e Këshillit Organizativ për 16 Qershorin .....                                                                                                                                                            | 9  |
| Shënohet Dita e Çlirimit dhe Dita e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës .....                                                                                                                                                   | 10 |
| Kryetari i Asociacionit të Komunave vizitoi Malishevën .....                                                                                                                                                                    | 12 |
| Banka Botërore financoi bibliotekën në SHMU "V.Pagarusha" .....                                                                                                                                                                 | 13 |
| Nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve.....                                                                                                                                                                                        | 13 |
| Ministrja Çitaku vizitoj komunën e Malishevës .....                                                                                                                                                                             | 14 |
| "Zhvillimin ekonomik i rajonit të Prizrenit përmes përmirësimit të potencialit turistik, infrastrukturës së turizmit, formimin e një Asociacioni turistik rajonal dhe orientimin e fillimit të biznesit në turizëm rural" ..... | 15 |
| U mbajt testi i arritshmërisë për semimaturantët.....                                                                                                                                                                           | 17 |
| Zëvendësministri i Punëve të Brendshme vizitoj komunën e Malishevës.....                                                                                                                                                        | 18 |
| Kryetari Kilaj, priti komandantin e kontingjentit gjerman të KFOR-it.....                                                                                                                                                       | 19 |



## **Bisedohet për ngritje të kapacitetit të ujësjellësit të Banjës e Malishevës dhe fshatrave që furnizohen nga ky ujësjellës**

### **Malishevë, 2 qershor**

Në një takim në zyrën e kryetarit të komunës së Malishevës, Isni Kilaj, në të cilin morën pjesë përfaqësues të HIDROREGJIONIT, pastaj nga USAID-i përkatësisht IRD, dhe nga HIDROING, është diskutuar për mundësitë e investimeve në ujësjellësin e Banjës, nga i cili furnizohen edhe banorët e qytetit të Malishevës, Mirushës, Lumishtës e Carrallukës.

Ky investim apo ky riinvestim ka të bëjë me NGRITJEN E KAPACITETIT TË UJIT dhe për një siguri në kapacitet.

Projekti për këtë riinvestim është hartuar nga Prof. Dr. Qemail Fejzullahu, ndërsa pritet që të investohet bashkërisht nga HIDROREGJIONI, IRD dhe HIDROING.

Kryetari i komunës Isni Kilaj, ka kërkuar nga të pranishmit, që mundësisht të bëhet një investim i tillë, ngase siç u shpreh ai “ me këto investime, do të rritet kapaciteti i ujit, do të ketë siguri më të madhe të teknologjisë së investuar, por edhe do të zvogëlohen shpenzimet energjetike”.

Sipas projektit, pritet që të bëhet ndërrimi i pompave, do të ketë riizolim, përforcim të kokave të gypave, apo thënë më gjithëpërfshirës, do të ketë një riorganizim, duke përfshirë edhe rezervuarët afër burimit të ujësjellësit.

Të pranishëm në këtë takim ishin drejtori i HIDROREGJIONIT, Besim Baraliu, Azem Kastrati-drejtor i IRD, Nebih Morina-drejtor i HIDROING-ut, e përfaqësues të tjetër nga këto institucione, si dhe hartuesi i projektit ideor për rritjen e kapacitetit të ujit, Prof.dr.Qemail Fejzullahu.

*Në lokalet e KFOR-it gjerman*

## **Bëhet pranim dorëzimi i sallës së sportit për SHMU "Imer Krasniqi" të Carrallukës**

### **Malishevë, 3 qershor**

Në një ceremoni zyrtare, sot në Prizren në lokalet e KFOR-it gjerman, është bërë pranim dorëzimi i një salle të sportit, për SHMU "Imer Krasniqi" të Carrallukës.

Kjo sallë deri tani është përdorur për ushtarakët e KFOR-it gjerman, ndërsa pas një marrëveshje të përbashkët me komunën, është vendosur që kjo sallë t'i dhurohet shkollës fillore të Carrallukës.

I pranishëm në pranim dorëzimin e saj ishte edhe stafi komunal i Malishevës, prirë nga kryetari Isni Kilaj, drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Isuf Morina, drejtoresha e shkollës Fatime Krasniqi, nxënës dhe arsimtar të shkollës.



Në fjalimin e tij, komandanti i KFOR-it, Dr. Ruppert, tha se ndihet i lumtur që po e dhuron këtë sallë për shkollën në fjalë. Sipas tij "kjo sallë është në funksion që nga viti 2002, dhe është përdorur për sporte të ndryshme për ushtarët tanë. Ne jemi të gëzuar që tashmë kjo sallë sporti do të zhvendoset në fshatin Carrallukë, dhe e cila do të shfrytëzohet nga nxënësit e kësaj shkolle".

Ndërsa në fjalën e tij kryetari i komunës së Malishevës, Isni Kilaj tha të jetë i gëzuar që së bashku me KFOR-in gjerman, po e bëjnë një investim tillë për nxënësit e Carrallukës. "Populli i Kosovës dhe ai i Malishevës në veçanti, i është mirënjohës popullit gjerman për mbështetjen e dhënë, në shumë sfera, e në veçanti në fushën e arsimit". Z. Kilaj, duke iu drejtuar komandantit Ruppert, shtoi "ju komandant keni gjetur formën më të mirë, për të mbetur në kujtesën e popullit të Malishevës, që përmes kësaj salle sporti, e cila do të jetë në shfrytëzim për qindra gjenerata, do të kujtoheni edhe ju, poashtu ndër breza të tërë".

Edhe drejtoresha e SHMU "Imer Krasniqi", Fatime Krasniqi, ka përshëndetur dhe ka falënderuar KFOR-in dhe komunën, për këtë investim.

Vlen të theksohet se nga dita e nesërme, do të fillojë çmontimi i kësaj salle sporti, e cila më pastaj do të montohet në oborrin e shkollës së Carrallukës. KFOR-i gjerman e ka dhuruar këtë sallë, ndërsa punët



rreth zhvendosjes së saj do t'i kryej komuna, e cila poashtu do të kryej edhe punët tjera përcjellës.

## **Këshilli i drejtorëve diskuton përgatitjet për festën e 16 Qershorit**

### **Malishevë, 6 qershor**

Këshilli i Drejtorëve, udhëhequr nga kryetari i komunës, Isni Kilaj, në mbledhjen e rregullt të ditës së sotme, ka diskutuar rreth përgatitjeve për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës.

Përveç për përgatitje është folur edhe për detyrat e drejtorive në kontekst të kësaj dite.

Janë diskutuar edhe çështje tjera, si projektet aktuale, mundësia e përfitimit të donacioneve nga grantet e organizatave të ndryshme, si dhe për rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në qytet dhe largimin e mbeturinave.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Halit Zogaj, ka raportuar për projektin e spërkatjes selektive, si masë parandaluese kundër infektimit me ethe krime kongo, ku me sukses ka përfunduar faza e parë e projektit, ndërsa me fazën e dytë do të vazhdohet, varësisht prej nevojës.

## **KO për shënimin e 16 Qershorit diskutoj shënimin e kësaj dite**

### **Malishevë, 7 qershor**

Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve, i formuar nga KK i Malishevës dhe i udhëhequr nga Kryetari i Komunës së Malishevës, Isni Kilaj, mbajti takimin e parë, ku u diskutua çështja e agjendës dhe e aktivitete që do ta shënojnë këtë ditë.

Përveç agjendës, Këshilli Organizativ ka diskutuar edhe disa nga çështjet teknike, ndërsa propozimet për tri çmimet tradicionale që ndahen çdo vit, Këshilli Organizativ, do t'i dërgoj për shqyrtim në Asamblenë Komunale.

KO, është formuar nga Asambleja Komunale, udhëhiqet nga kryetari i komunës, ndërsa anëtar të tij janë, përfaqësuesit e subjekteve politike, përfaqësuesit e tri shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, Qendrës Rinore dhe Handikos-it.

## Hapet zyra për regjistrim e bizneseve

### **Malishevë, 8 qershor**

Sot edhe zyrtarisht, është hapur Zyra për Regjistrimin e Bizneseve në Malishevë. Shiritin e përrurimit të kësaj zyre, e prenë kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë për Tregti dhe Industri, z.Mehdi Pllashniku.



“Kjo zyrë, do të jetë stimulim për bizneset dhe në të njëjtën kohë për zhvillimin ekonomik, pasi më nuk do të humbet kohë që regjistrimin e bizneseve ta bëjnë në Ministrinë e Tregtisë në Prishtinë, e konsiderojmë se kjo është një përparësi për ne të gjithë. Shumë shpejt kjo zyre, do të transferohet në Qendrën e Biznesit në Malishevë, ku është duke u ndërtuar, dhe çdo gjë do të jetë më lehtë dhe një e mirë që i bëhet biznesit”, tha kryetari Kilaj, me rastin e hapjes së kësaj zyre.

## KKSB e vlerëson të qetë sigurinë në Malishevë

### **Malishevë, 8 qershor**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), në mbledhjen e rregullt të saj, të kryesuar nga drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Halit Zogaj, e vlerësoi të qetë dhe stabile situatën e sigurisë së përgjithshme në Malishevë, përderisa rastet e tentim vetëvrasjeve dhe aksidentet në trafik, mbesin shqetësuese.

Në këtë mbledhje, u raportua për situatën epidemiologjike dhe fushatën e spërkatjes së zonave endemike, si masë parandaluese nga infektimi me virusin e etheve hemorragjike “krime kongo”, me c’rast u raportua se faza e parë e projektit ka përfunduar me suksese, ndërsa nuk është regjistruar asnjë rast i infektuar.

Në anën tjetër, u.d. i komandantit të stacionit policor në Malishevë, togeri Bekim Begaj, ka njoftuar për situatën e sigurisë, ku sipas tij, situata është e qetë dhe stabile, ndërsa shqetësuese janë rastet e tentim vetëvrasjeve dhe aksidentet në komunikacion.

Togeri Begaj, po ashtu njoftoi se Policia e Kosovës, ka marrë masa shtesë për krijimin e sigurisë së lëvizjes së qytetarëve, me rastin e shënimit të 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe ditës së Dëshmorëve të Malishevës.

## Pallati i sporteve, pritët të hapet në vjeshtën e këtij viti

### Malishevë, 8 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur një delegacion nga departamenti i sportit në Ministrinë për Kulturë Rini dhe Sport, të udhëhequr nga shefi i këtij departamenti z.Ibër Alaj, me qëllim të njoftimit mbi ecurinë e punimeve në Pallatin e Sportit në Malishevë.

“Pallati i Sporteve në Malishevë, pritët të hapet në vjeshtën e këtij viti, bazuar në ecurinë e punimeve që janë duke u bërë”, ka thënë Ibër Alaj, shef i departamentit të sportit në MKRS.

Në këtë takim, u diskutua edhe për çështje teknike, kryesisht për hapësirën e jashtme të pallatit, si rruga, parkingu dhe çështje tjera, të cilat e kompletojnë objektin më të madh dhe më të kushtueshëm, deri më tani në sportin e Malishevës.

## Komuna dhe UN-HABITAT-i nënshkruan memorandum mirëkuptimi

### Malishevë, 9 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur në zyrën e tij, përfaqësuesin e Programit të Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-HABITAT) në Kosovë, Ishaku Miatumba, me ç'rast kanë nënshkruar një

memorandum mirëkuptimi, për zbatimin e programit për mbështetjen e planifikimit hapësinor komunal.

Për komunën e Malishevës, këtë memorandum e ka nënshkruar kryetari Kilaj, ndërsa për UN-HABITAT-in, do ta nënshkruaj përfaqësuesi i saj, në Nairobi të Kenias, ku edhe gjendet selia e kësaj agjencie.

Sipas këtij memorandumi, komuna e Malishevës, do ta hartoj një projekt për planifikimin urbanistik hapësinor të Malishevës, ndërsa UN-HABITAT-i, do të ndihmoj në hartimin e projektit përmes këshillave profesionale dhe komenteve teknike.

Për hartimin e këtij projekti dhe si partner për bashkëpunim me UN-HABITAT-in, komuna ka formuar edhe grupin udhëheqës, grupin bërthamë dhe ekipin komunal të planifikimit, nga përgjegjësit e drejtorive të caktuar dhe zyrtarët përgjegjës komunal.

## KFOR: Malisheva vend i qetë

### **Malishevë, 9 qershor**

Kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot, zv/komandantin e KFOR-it, Gjeneral Brigade, Marco Serronha, i cili vlerësoi se “situata e sigurisë është në nivel, se Malisheva është një vend i qetë dhe i mirë për të jetuar dhe që i vjen mirë për këtë”

Zv/komandanti i KFOR-it, është takuar me autoritet e komunës së Malishevës, në kuadër të vizitave të tij, në ekipet ndërlidhëse të KFOR-it, LMT, dhe falënderoi komunën për bashkëpunimin e mirë me LMT-në, si dhe u interesua për Malishevën në përgjithësi.



Kryetari Kilaj, e njoftoi zv/komandantin e KFOR-it, me Malishevën, pozitën gjeografike, numrin e banorëve, zhvillimin ekonomik. “Malisheva është një vend kryesisht bujqësor, ndërsa një pjesë e madhe qytetarëve jetojnë jashtë vendit, kurse problem është papunësia dhe menaxhimi i mbeturinave”, tha Kilaj.

“Çdo gjë që shihni sot, është e re, nga lufta kemi dalë me 87 për qind të shtëpive të shkatërruara, ndërsa sot kemi 36 shkolla, shumë rrugë të asfaltuara, kanalizime, ujësjellës”. Sa i përket KFOR-it, kryetari Kilaj tha se “për Malishevën, KFOR-i është njëra prej organizatave më të respektuara, për shkak të kontributit të saj në çlirimin e Kosovës, por edhe në ruajtjen e sigurisë dhe paqes”.

Kilaj dhe zv/komandanti i KFOR-it, M. Serronha, biseduan edhe për mundësitë e zhvillimit të turizmit në Malishevë, pasi Malisheva ka resurset e saja natyrore, si Pishinat në Banjë, Ujëvarat e Mirushës dhe shpellat e pa hulumtuara.

## **Bordi i Drejtorëve diskuton përgatitjet përfundimtare për shënimin e 16 Qershorit**

### **Malishevë, 13 qershor**

Këshilli i drejtorëve, i kryesuar nga kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, në mbledhjen e rregullt (të sotme), diskutoi për përgatitjet përfundimtare të organizimit, për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të komunës së Malishevës.

Kryetari Kilaj, kërkoi nga drejtorët dhe stafi i tyre, që të jenë të angazhuar maksimalisht, që çdo gjë të shkojë sipas planit dhe orarit të aktiviteteve që janë parashikuar të mbahen, si homazhet, përrurimi i Shtëpisë së Kulturës, programi artistik dhe aktivitete tjera, deri në organizimin e koncertit të mbrëmjes.

Ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës, kryetari Kilaj, e quajti “vepra më e madhe e kulturës në Malishevë dhe një ëndërr të bërë realitet”.

Po ashtu në këtë mbledhje u kërkua që mirëmbajtja e qytetit të jetë në nivelin më të lartë të pastërtisë, si dhe qyteti të jetë i dekoruar.

Këshilli i Drejtorëve, mori vendim për ndihmë një fermeri, në Mirushë, të cilit gjatë këtij vikendi, ujqit i kanë dëmtuar 67 dele. Komuna do të ndihmojë këtë fermer me dy mijë euro.

## **KK miratoi propozimet e Këshillit Organizativ për 16 Qershorin**

### **Malishevë, 14 qershor**



Asambleja Komunale e Malishevës, në mbledhjen e sotme, ka shqyrtuar dhe miratuar propozimet e Këshillit Organizativ për të propozuarit për trimimet tradicionale që ndahen më 16 Qershor, në Ditën e Çlirimit dhe Dëshmorëve të Malishevës.

Në këtë mbledhje, të cilën e udhëhoqi kryesuesi Ragip Begaj, Kryetari i Komunës dhe kryetar i Këshillit Organizativ, Isni Kilaj, ka prezantuar para këshilltarëve komunal, propozimet e këshillit, për gjashtë emrat të cilët do ti marrin tri çmimet atë për, “Imer Krasniqi”, “Hamdi Berisha” dhe “Shpëtim Robaj”.

Sipas nenit 9, pika 9.3 e statutit të komunës së Malishevës, për nder të Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve, Kuvendi Komunal i Malishevës, dekoron personalitete të caktuara, për kontributin e tyre. Çmimet që ndahen janë: Për trimëri dhe heroizëm “Imer Krasniqi”, për kontribut në arsim “Hamdi Berisha” dhe për kontribut në shëndetësi “Shpëtim Robaj”.

Me vendim të KK të Malishevës, çmimi për trimëri dhe heroizëm “Imer Krasniqi” për këtë vit shkon për veteranët e UÇK-së, Sali Paçarizi dhe Naser Krasniqi, çmimi për kontributin e dhënë në arsim shkon për veteranët e arsimit Ismail Krasniqi dhe Ramadan F.Thaçi dhe çmimi për kontribut në shëndetësi shkon për Isuf Telakun dhe Sadik Krapin.

## Shënohet Dita e Çlirimit dhe Dita e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës

### Malishevë, 16 qershor

Komuna e Malishevës, ka shënuar sot Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve. Fillimisht janë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Kleçkë dhe Malishevë, pastaj nderime para shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, e më pas është bërë përrurimi i Shtëpisë së Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, ku edhe është mbajtur manifestimi qendror.

Shiritin e për përrurimit e bënë, Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, djali i dëshmorët të kombit



Tahir Sinani, Rrezarti, zv/ministri i MPMS, z.Fatmir Shurdhaj dhe kryetari i degës së OVL të UÇK-së, z.Enver Hoti.



Po ashtu janë ndarë edhe çmimet tradicionale. Sipas vendimit të KK të Malishevës, çmimi për trimëri dhe heroizëm “Imer Krasniqi” për këtë vit shkon për veteranët e UÇK-së, Sali Paçarizi dhe Naser Krasniqi, çmimi për kontributin e dhënë në arsim shkon për

veteranët e arsimit Ismail Krasniqi dhe Ramadan F.Thaçi dhe çmimi për kontribut në shëndetësi shkon për Isuf Telakun dhe Sadik Krapin.

Po ashtu, sot, është ndarë edhe çmimi “Qytetar nderi” i Malishevës, për ambasadorin e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë, Sverre Johan Kvale, për kontributin e dhënë për Malishevën. Çmimi do ti jepet në një ceremoni tjetër. **Në vazhdim, fjalimi i Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj.**

*Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, të nderuara familje të dëshmorëve, invalidë e veteranë, përfaqësues të subjekteve politike e fetare, të Policisë së Kosovës, përfaqësues ndërkombëtarë, të nderuar pjesëmarrës,*

*Edhe sivjet jemi bashkë që të kremtojmë Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.*

*Dhe sa herë ta kujtojmë këtë datë të shënuar të historisë sonë, pa dyshim se do të kujtojmë sakrificat e gjeneratave përgjatë tërë historisë sonë të lavdishme të cilat u kurorëzuan me luftën madhështore të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e cila u bë kurorë e këtyre përpjekjeve që solli lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.*

*Sot, në këtë ditë të shënuar, edhe njëherë përulemi para sakrificës madhështore të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari, përulemi para gjakut të derdhur të mijëra dëshmorëve të Kosovës, para gjakut të derdhur të 70 dëshmorëve dhe qindra martirëve të Malishevës.*

*Sot, në këtë ditë të shënuar, me krenari kujtojmë qëndresën e pa shembullt të qytetarëve të Malishevës, kujtojmë qindra beteja të zhvilluara në tërë territorin e kësaj komune në të cilat mbrohej nderi i shqiptarit dhe nderi i Kosovës.*



*Në përpjekje për të realizuar ëndrrën e dëshmorëve, ne përfaqësuesit e institucioneve të zgjedhura nga qytetarët, po vazhdojmë të punojmë me të gjitha mundësitë për një jetë më të mirë për të gjithë.*



*Gjatë këtyre viteve të pasluftës, ne së bashku, nga gërmadhat ngritëm një qytet dhe me përpjekje të mëdha realizuam projekte të cilat përmirësuan jetën tuaj.*

*Në këtë kuptim, ne edhe sivjet në Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve mund të flasim për dhjetëra projekte të kryera si Qendra e Kompetencës, Ujësjellës, Kanalizime, rrugë të asfaltuara, trotuare e të tjera kurse pikërisht në këtë Ditë të Madhe ne po përurojmë Shtëpinë e Kulturës, një objekt ky i rëndësisë kapitale i cili i ka munguar Malishevës.*

*Sivjet, në këtë ditë të madhe, ne kemi përgatitur edhe një dokumentar përmes të cilit pasqyrojmë ecjen tonë, zhvillimin tonë që nga paralufta e deri më sot duke kujtuar kontributin e dhënë nga të gjithë në periudha të caktuara të zhvillimit.*

*Të nderuar pjesëmarrës, të nderuar qytetar të Malishevës,*

*Ne edhe sot, zotohemi se do të vazhdojmë të punojmë me të gjitha forcat për zhvillimin e Malishevës me qëllimin e vetëm që ju të jetoni më mirë.*

*Gëzuar Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve*

*Lavdi Dëshmorëve të kombit dhe të gjithë atyre që dhanë jetën për liri...*

## **Kryetari i Asociacionit të Komunave vizitoi Malishevën**

### **Malishevë, 22 qershor**

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim, kryetarin e Asociacionit të Komunave të Kosovës, z. Bajrush Xhemajli.

Pasi ka falenderuar për vizitën, z. Kilaj e ka njoftuar z. Xhemajli me gjendjen e përgjithshme në komunën që ai drejton. Ndërkohë ky i fundit, ka vlerësuar lartë të arriturat e komunës së Malishevës.

Me këtë rast janë vizituar edhe disa nga projektet madhore, që kanë përfunduar ose që janë në përfundim e sipër, si : Qendrën e Kompetencës, Shtëpinë e Kulturës, Palestrën e Sporteve, etj.

Kjo vizitë është bërë, në kuadër të vizitave që kryetari i Asociacionit të Komunave z. Bajrush Xhemajli, iu bënë komunave të Republikës së Kosovës.



## **Banka Botërore financoi bibliotekën në SHMU “V.Pagarusha”**

### **Malishevë, 27 qershor**

Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët (SHMU) “Vesel Pagarusha” në Pagarushë, është bërë me bibliotekë të kompletuar, falë një donacioni të Bankës Botërore dhe e përkrahur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Sipas drejtorit për Arsim dhe Edukim, z.Isuf Morina, “ky projekt i financuar nga Banka Botërore, kap një shumë prej 6 285 euro, ndërsa kjo bibliotekë, është bërë thuajse nga zero, ndërsa tani është e kompletuar”.

“Biblioteka, tani është e pajisur me librat si lektura komplet prej parafillorë e deri ne klasën e nëntë, pastaj fjalorë, enciklopedi, romane, atlas, por është kompletuar edhe me rafte, karrige, tavolinë, laptop, printer, skaner, videoprojektor dhe fotokopje”, tha Morina.

Kjo bibliotekë është një shtytje për te përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe njëkohësisht në përputhje me planin zhvillimor të shkollës për periudhën 2011—2014 .

## **Nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve**

### **Malishevë, 27 qershor**

Në mbledhjen e sotme të Bordit të Drejtorëve e kryesuar nga kryetari i komunës, z. Isni Kilaj, u trajtuan disa çështje që kanë të bëjnë me , vlerësime dhe planifikime.

Kryetari Kilaj, vlerësoj mbarëvajtjen e 16 Qershorit Ditës së Clirimit dhe Ditës së Dëshmorëve. “ Konsideroj se 16 Qershori, ka kaluar mirë, organizimi dhe aktivitetet kanë shkuar në bazë të planifikimeve”, tha mes tjerash z. Kilaj.

Më pastaj është diskutuar raporti i auditimit gjeneral, i cili është vlerësuar i kënaqshëm, mirëpo kryetari dhe menagjmenti i qeverisë lokale, u zotuan për ngritje të performancës në disa nga pikat që janë dhënë vërejtje, konkretisht të funksionalizimi i Komisionit (i cili ekziston) për Vlerësimin e Pasurisë, ndërkohë që kryetari premtoj për sigurimin e një softëri për futjen e të dhënave, vetëm për këtë çështje.

## Ministrja Çitaku vizitoj komunën e Malishevës

### Malishevë, 27 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim Ministren e Integritimeve Europiane, znj. Vlora Çitaku.

Qëllimi i kësaj vizite sipas ministres Çitaku, ishte në vazhden e takimeve që është duke iu bërë komunave të Republikës së Kosovës, për tu njohur për së afërmi me gjendjen e riintegritimit të personave, apo komuniteteve të kthyer qoftë nga shtetet perëndimore, apo edhe të atyre të komunitetit joshqiptar.

Kryetari i komunës së Malishevës, z. Kilaj, e ka njoftuar ministren për gjendjen në

këtë kontekst, dhe ka falënderuar njëkohësisht për vizitën. Më pas është njoftuar edhe me kriteret e kërkuara nga ministria në fjalë, që kanë të bëjnë me të kthyerit, e që në këtë rast në komunën e Malishevës, përveç një rasti që ka bërë kërkesë për tu kthyer në Kosovë, nuk ka raste të tjera, pa përjashtuar edhe disa familje nga komuniteti i RAE-it, që kanë jetuar edhe më parë në këtë komunë, e të cilat tashmë janë regjistruar, përmes deklarimit të tyre, si kosovar.

“Unë kërkoj nga ju, që si komunë, nëse paraqitet ndonjë rast i tillë, ta evidentoni, t’i vizitoni, t’i sistemoni (nëse kërkohet nevoja), t’i pajisni me dokumentacion, si dhe t’i inkorporoni në jetën sociale, arsimore, etj”, kështu është shprehur në mes tjerash ministrja Çitaku, e cila gjithashtu ka kërkuar që të apelohet tek qytetarët që të mos tentojnë për të kërkuar azil në shtetet jashtë Kosovës, ngase një gjë e tillë është e papranueshme, nga shtetet ku ata eventualisht kërkojnë azil”. Sipas znj. Çitaku, numri i madh i azilkërkuesve, mund ta neglizhoj procesin e liberalizimit të vizave.

Kryetari Kilaj, i ka premtuar Ministres Çitaku, që “sa i përket kriterëve që kërkohen nga komuna, ju garantoj se nuk do të ketë ngecje në asnjë çështje”.

Rreth kësaj teme folën edhe zyrtarja për kthim dhe komunitete në komunën e Malishevës, znj. Ardita Krasniqi, dhe zyrtari për Integritime Europiane, z. Bashkim Krasniqi.

*Midis komunës së Malishevës dhe ASB-së nënshkruhet memorandum*

**“Zhvillimin ekonomik i rajonit të Prizrenit përmes përmirësimit të potencialit turistik, infrastrukturës së turizmit, formimin e një Asociacioni turistik rajonal dhe orientimin e fillimit të biznesit në turizëm rural”**

**Malishevë, 28 qershor**

Midisi komunës së Malishevës, në këtë rast kryetarit Isni Kilaj dhe Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland eV (ASB), me kryesuese Dafina Hoxha, është nënshkruar një memorandum, në lidhje me “Zhvillimin ekonomik të rajonit të Prizrenit përmes përmirësimit të potencialit turistik, infrastrukturës së turizmit, formimin e një Asociacioni turistik rajonal dhe orientimin e fillimit të biznesit në turizëm rural”.



Sipas këtij memorandum, “ASB dhe bashkëpunëtorët e projektit do të bashkëpunojnë në implementimin e aktiviteteve të projektit me një kohëzgjatje të planifikuar, prej majit të këtij viti deri në vitin 2012”. Nënshkruese të këtij memorandum janë edhe komunat e Rahovecit dhe Mamushës.

Fushat në të cilat do të punohet janë: identifikimi dhe profilizimi i familjeve potenciale rurale, komponenti i edukimit, orientimi i ndihmës teknike, përmbushja e aktiviteteve promovuese, etj.

Ndërsa sa i përket rezultateve të këtij projekti, është planifikuar rritje e kapaciteteve të biznesit përmes trajnimeve dhe ndihmës teknike për të siguruar 12 familje rurale në rajonin e Prizrenit ( përfshirë këtu edhe komunën e Malishevës), për fillimin e biznesit të tyre të duhur; rritje e aftësive teknike përmes trajnimit të artizanateve autoktone; rritje e njohurive operative, etj.

Me këtë rast kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka përshëndetur këtë iniciativë, duke e vlerësuar shumë pozitive, ndërkohë që është falënderuar nga kryesuesja e ASB-së, znj. Dafina Hoxha, për mundësinë e bashkëpunimit.

## Përfundoi ndërtimi i Qendrës së Kompetencës

Malishevë, 28 qershor



Sot është bërë pranim-dorëzimi dhe hapja përfundimtare e Qendrës së Kompetencës në Malishevë, si dhe zyrtarisht kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, ja dorëzoi titullin “Qytetar nderi” i Malishevës, ambasadorit të mbretërisë së Norvegjisë në Kosovës, shkëlqesisë së tij, Sverre Johan Kvale.

Në ceremoninë e sotme, kanë marrë pjesë, ambasadori i mbretërisë së Norvegjisë, Sverre Johan Kvale, përfaqësues të korit diplomatik në Kosovë, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z.Ramë Buja dhe zyrtarë të tjerë vendor e ndërkombëtar, si

nga kori diplomatik në vend, deputet dhe qeveritar.

“Ambasadori Kvale e ka respektin e 70 mijë banorëve të Malishevës dhe malishevasit, ju jemi mirënjohës për jetë juve ambasador, qeverisë suaj dhe popullit norvegjez, si dhe MASHTK-së, për ndërtimin e kësaj shkolle, kapitale për neve”, tha kryetari Kilaj, duke i falënderuar të gjithë ata që ndihmuan në ndërtimin e shkollës. “Malisheva dhe populli i saj, sot ka një dritare të hapur, përmes së cilës e shohim botën ndryshe”, tha Kilaj, duke folur për rëndësinë e kësaj shkolle profesionale.



Në përfundim të fjalimi të tij, kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, ja dorëzoi edhe titullin “Qytetar nderi” i Malishevës, shkëlqesisë së tij, ambasadorit të mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë, Sverre Johan Kvale, për kontributin e dhënë për Malishevën.

Pasi falënderoi për titullin, ambasadori Kvale, tha “se kjo është një ditë e lumtur për arsimin në Kosovë, për këtë shkollë të ndërtuar me standardet më të larta evropiane”. “Kosova ka popullatën më të re në Evropë dhe shkallë të lartë të papunësisë, por një hapësirë e madhe e ndërtimit dhe njerëzit që do të diplomojmë këtu, do të jenë me aftësi profesionale, aftësi për të cilën ka nevojë Kosova”, tha Kvale duke arsyetuar këtë investim kapital për Malishevën, e cila njëherit është edhe obligim i tyre para Bankës Botërore dhe OKB-së. Ambasadori Kvale, falënderoi ish ministrin e arsimit, z.Enver Hoxhaj, ministrin e tanishëm, z.Ramë Buja dh enë mënyrë të veçantë, kryetarin e Malishevës, Isni Kilaj, për bashkëpunimin e shkëlqyer dhe përmbushjen e obligimeve. “Kilaj, është një model i bashkëpunimit të mirë”, tha Kvale.

Ndërsa për ministrin Ramë Buja, “kjo është një ditë e veçantë, pasi është një objekt që se ka askush në rajon dhe me këtë ne vazhdojmë të realizojmë cilësinë, e cila ka çaluar deri tani”. Pasi falënderoi të gjithë ata që bënë që të ndërtohet kjo shkollë, ministri Buja, dha një porosi për nxënësit e kësaj shkolle. “Është lehtë të realizosh , por vështirë ta ruash, prandaj ruajeni dhe gëzoheni këtë shkollë”, tha në fund ministri Buja.

## U mbajt testi i arritshmërisë për semimaturantët

### Malishevë, 29 qershor



Organizuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Drejtoria Komunale për Arsim dhe Edukim, u mbajt testi i arritshmërisë për nivelin e klasave të nënta.

Testi është mbajtur në tri qendra shkollore për të gjithë nxënësit e Komunës së Malishevës, të cilët e kanë përfunduar klasën e nëntë.

“Testit të arritshmërisë, i janë nënshtruar 1295 nxënës të klasave të nënta”, deklaroi

drejtori i DKA, z. Isuf Morina. Sipas tij, përmes kësaj, do të vlerësohet edhe shkalla e nxënies së dijes, por edhe nivel i dhënies së dijes, dhe përmes kësaj nxënësit do të mund të orientohen edhe për regjistrim në drejtimet përkatëse të nivelit të mesëm të arsimit.

## Zëvendësministri i Punëve të Brendshme vizitoj komunën e Malishevës

### Malishevë, 29 qershor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj me bashkëpunëtor, ka pritur sot në takim zv.ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme z. Izmi Zeka, me stafin përcjellës, me ç'rast janë diskutuar disa çështje, e ndër më të rëndësishmet ishte ajo për riintegrimin e të riatdhesuarve, si standard që ka të bëjë me liberalizimin e vizave.



Kryetari Kilaj, përveç çështjes së riintegrit të të riatdhesuarve, për çka shprehu edhe gatishmërinë personale, përmendi edhe disa çështje të tjera, që kanë të bëjnë me interesat

e qytetarëve të komunës që ai drejton. Konkretisht u diskutua puna e Stacionit të Policisë në këtë komunë, i cili tash e sa kohë është me ushtrues detyre, ndërsa ka potenciale për gradime në atë të kapitenit, gradë kjo që duhet ta ketë komandanti i Stacionit të Policisë. Çështje tjetër që bie poashtu në kompetenca të kësaj ministrie është edhe Qendra për regjistrimin e automjeteve, për ç'gjë kryetari Kilaj, kërkoj që stafi aktual i cili gjendet në këtë qendër regjistrimi e që vjen nga komuna e Rahovecit, të zëvendësohet me staf nga komuna e Malishevës.

U diskutua edhe puna e ofiqarëve, si qendër civile, për çka ministri u njoftua nga kryetari dhe nga drejtori i Administratës së Përgjithshme, z. Haki Krasniqi. Në këtë kontekst zv.ministri Zeka tha se “edhe arkivimi i dokumentacionit është një prej standardeve që duhet plotësuar, ndërsa sa i përket riintegrit për të riatdhesuarit, nëse keni ndonjë kërkesë, atëherë adresojeni atë tek ne, sepse ne e kemi për obligim për të ndihmuar”, kështu u shpreh midis tjerash ministri Zeka.

Një shqetësim i ngritur nga kryetari i Komunës së Malishevës, ishte edhe ai i vendbanimeve, që bazuar në shënimet e mëhershme, figurojnë më pak vendbanime sesa që në fakt janë me statut të komunës, gjithsej 44 vendbanime, përfshirë këtu edhe qendrën e qytetit. “Kjo gjë, po na paraqet problem, sepse qytetarët e komunës së Malishevës, duan të kenë dokumentacion, në bazë të vendbanimeve, që i kemi me statut të komunës”. Në këtë kontekst, Blerim Canaj nga MPB, tha se “pasi që Ligji për sistemimin e adresave të kaloj në Agjencionin Kadastral, çdo gjë do të rregullohet”.

Në fund të takimit u shkëmbyen falënderime për pritjen, respektivisht vizitën, nga Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe kryetari i Komunës së Malishevës.

## Kryetari Kilaj, priti komandantin e kontingjentit gjerman të KFOR-it

**Malishevë, 29 qershor**



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur sot në zyrën e tij, komandantin e trupave gjermane të KFOR-it, kolonelin Rubbert, me të cilin biseduan për bashkëpunimin mes komunës dhe KFOR-it, si dhe për çështje tjera, që lidhen me zhvillimet e përgjithshme në Malishevë.

Kryetari Kilaj, pasi falënderoi për vizitën e komandantit të kontingjentit gjerman, kolonelin Rubbert, tha se “uniforma për neve, nënkupton sigurinë”. Z. Kilaj falënderoi komandantin, edhe për

ndihmën e fundit të KFOR-it gjerman, për dhurimin e sallës së sporteve, për shkollën e fshatit Carrallukë.

Në anën tjetër, komandanti i kontingjentit të trupave gjermane të KFOR-it, kolonel Rubbert u interesua për situatën e përgjithshme në Malishevë, në veçanti për zhvillimin ekonomik të Malishevës dhe atë të sigurisë.

Kryetari Kilaj, e njoftoi atë me situatën ekonomike në Malishevë, me problemin e papunësisë, si dhe me investimet e komunës, në fushën e infrastrukturës së përgjithshme, si parakusht për zhvillimin ekonomik.

Pas takimit, koloneli Rubbert, vizitoi edhe Qendrën e Kompetencës në Malishevë.